

Për Reduktim nga Tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të dytë për vitin akademik 2023-2024.

Në zbatim të :

VKM-ve

VKM Nr. 780, datë 26.12.2018 (Cikli II);

“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programe të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të Arsimit të Lartë”; dhe që ju përkasin kategorive sociale sipas përcaktimeve në **VKM Nr. 269, datë 29.03.2017, (ndryshuar) dhe VKM Nr. 780, datë 26.12.2018**, duhet të plotësojnë dokumentacionin sipas tabelës më poshtë, për përfitim / reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2023– 2024.

Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzojnë studentët për Reduktim 50% (Cikli i dytë)

N r	Kategoria	Dokumentacioni i nevojshëm i studentit
1	Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë	• Kopje ID • Vërtetim i pagesës nga DRSSH • Noterizim i vendimit të K.M.C.A.P
2	Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore	• Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetimi pagesës nga DRSSH • Noterizim i vendimit të KMCA për prindin me aftësi të kufizuar.
3	Studentët, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore	• Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetim nga Njësia administrative vendore që familja e studentit trajtohet me ndihmë ekonomike
4	Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;	• Çertifikatë familjare • Kopje ID • Dokumentacioni që tregon gjendjen financiare të familjes së studentit / es
5	Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;	• Kopje kartë identiteti • Vërtetim të statusit të jetimit
6	Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;	• Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vendim gjykatë të formës së prerë
7	Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore;	• Kopje ID • Vërtetim nga Ministria e Brendshme.
8	Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;	• Kopje ID • Shkresa nga Ministria përkatëse.
9	Studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale;	• Kopje ID • Formulari i vetëdeklarimit
10	Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;	• Çertifikatë familjare • Kopje ID • Vërtetim nga instituti i të përndjekurve politikë
11	Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);	Cikli i Dytë (Master) • Listat e studentëve përfitues vijnë nga Sekretaria Mësimore.
12	Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.	Cikli i Dytë (Master) • Listat e studentëve përfitues vijnë nga Sekretaria Mësimore.

Dokumentacioni dorëzohet pranë Degës së Shërbimeve FE-UT (kati i dytë godina 3-katëshe A) brenda datës 10 nëntor 2023 ora 9:00-15:00

Email: degasherbimeve@feut.edu.al